

# Sfidat dhe trendët e KSP-së: Roli i FMN-së

**6 TETOR 2021**

Sagé de Clerck
Ekonomiste e Lartë, Departamenti i Çështjeve Fiskale

# Përmbajtja

- Hyrje
- Roli i FMN-së në reformat e kontabilitetit
  - Kuadri konceptual
  - Puna operative
- Sfidat për të ardhmen

# Hyrje



- Është mirë të reflektohet një çast se nga vijmë
- Është mirë të vlerësojmë se ku jemi
- Është mirë të mendojmë për sfidat që na presin

# Roli i FMN-së në reformat e kontabilitetit: Kuadri konceptual

- Publikimi në 1993 i Sistemit të Llogarive Kombëtare e përfshiu në mënyrë aktive FMN-në në problematikat e raportimit me të drejta dhe detyrime të konstatuara – kjo u pasua me Manualin e Statistikave Financiare Shtetërore (GFSM) 2001
- Përditësimi i Sistemit të Llogarive Kombëtare 1993 çoi në ngritjen e **Task-Forcës për Harmonizimin e Kontabilitetit të Sektorit Publik (TFHPSA)** në tetor 2003



# Roli i FMN-së në reformat e kontabilitetit: Kuadri konceptual (2)

- Bashkëpunimi kulminoi në **SNA 2008** dhe **GFSM 2014**
  - U eliminuan disa dallime të panevojshme midis kuadrit kontabël dhe kuadrit statistikor
  - U shtua Shtojca 6 në GFSM 2014 – Krahasimi i SNKSP-ve dhe udhëzimeve statistikore
- **Bashkëpunimi vijoi** përmes Grupit Këshillimor për Statistikat Financiare Shtetërore dhe statusit si vëzhgues të FMN-së në BSNKSP që solli si rezultat:
    - Miratimin e politikës së BSNKSP-së për të marrë parasysh bazën statistikore të raportimit në hartimin e standardeve
    - Paneli i ngjashmërive dhe dallimeve i BSNKSP-së ndihmon një vlerësim të rregullt të situatës
    - Dokumente diskutimi për raundin e ardhshëm të përditësimeve të manualeve statistikore

Marrëdhënia simbiotike midis standardeve të kontabilitetit, udhëzimeve statistikore dhe këshillave për reformat e financiare publike nga e cila përfitojnë të gjitha profesionet

# Roli i FMN-së në reformat e kontabilitetit: Puna operative

Tërthorazi, puna operative e FMN-së mbështet dhe nxit më tej përmirësimin e kontabilitetit për qeveritë në vendet anëtare, me anë të:

- Punës vëzhguese dhe mbështetjes financiare për anëtarët
- Standardeve të të dhënave
- Zhvillimit të kapaciteteve
- Punës kërkimore, këshillave dhe analizave

# Roli i FMN-së në reformat e kontabilitetit: Vëzhgimi dhe mbështetja financiare

- Statuti i FMN-së, neni VIII, pika 5
  - U kërkon anëtarëve t'i vendosin në dispozicion FMN-së informacionet që i konsideron të nevojshme për veprimtaritë e veta
  - Kërkesat mbi të dhënat financiare të hartuara me kalimin e kohës në lidhje me
    - Mbulimin institucional
    - Mbulimin e flukseve dhe gjendjet e stokut
    - Klasifikimet
    - Bazën e raportimit
- Statuti i FMN-së, neni IV, pika 3 lejon mbajtjen nën vëzhgim të vendeve anëtare
  - Rëndësia e të dhënave financiare në veprimtaritë e vëzhgimit është rritur me kalimin e kohës
  - Kuadri i raportimit buxhetor është shtrënguar me kalimin e kohës
  - Disa dokumente të këshillit dhe vendime të mëpasshme kanë kontribuar në përmirësimin e raportimit buxhetor:
    - 2005 Përdorimi i Kuadrit Statistikor GFSM 2001 për të fuqizuar analizën buxhetore të Fondit
    - 2010 Statistikat Financiare Shtetërore për fuqizimin e analizës buxhetore
    - 2013 dhe 2017 Shqyrtim i vënies në zbatim të Kuadrit të Statistikave Financiare Shtetërore për të fuqizuar analizën buxhetore
- Statuti i FMN-së, neni V, pika 3 trajton kushtet që rregullojnë përdorimin e burimeve të përgjithshme të Fondit
  - Vendet anëtare që kanë nevojë për mbështetje financiare shpesh u nënshtrohen kushtëzimeve – përfshirë edhe kushtet që kanë të bëjnë me raportimin buxhetor

# Roli i FMN-së në reformat e kontabilitetit: Standardet e të dhënave




Nismat për standardet e të dhënave kanë evoluar me ndryshimin e nevojave të vendimmarrësve të politikave

- Standardet e të dhënave kanë mbështetur vendet për të respektuar kërkesat lidhur me mbulimin, shpeshtësinë, kohën, metodikën etj.
  - Standardi i Posaçëm për Shpërndarjen e të Dhënave (SDDS) u vendos në 1996
  - Sistemi i Përgjithshëm për Shpërndarjen e të Dhënave (GDD) u vendos në 1997
  - SDDS Plus u vendos në 2012
  - e-GDDS (kategoritë e harmonizuara të të dhënave me tregues të përbashkët për vëzhgimin)
- Këto standarde të dhënash shoqërohen me metadata
- Pas vitit 2003 u krijua një Kuadër për Vlerësimin e Cilësisë së të Dhënave – cilësia e të dhënave vlerësohet duke përdorur një strukturë me gjashtë pjesë që lidh mjedisin institucional, proceset statistikore dhe karakteristikat e produkteve statistikore

# Roli i FMN-së në reformat e kontabilitetit: Zhvillimi i Kapaciteteve (ZHK)

Zhvillimi i kapaciteteve (asistenca teknike) jepet me:

- Kërkesë të autoriteteve
- Kërkesë të ekipeve të vendeve

Zhvillimi i kapaciteteve ofrohet me anë të:

- Instrumenteve diagnostikuese, për shembull:
  - Vlerësimi për Transparencën Buxhetore (FTE)
  - Vlerësimet për Menaxhimin e Investimeve Publike (PIMA)
  - Paketa e instrumenteve për risqet buxhetore
- Misionet tematike për zhvillimin e kapaciteteve, me tema të tilla si:
  - Reformat kontabël
  - Reformat e planit kontabël të standardizuar
  - Menaxhimi i borxhit
  - Raportimi buxhetor në përgjithësi



# Roli i FMN-së në reformat e kontabilitetit: Këshilla të posaçme, punë kërkimore dhe analizë (1)

- Këshillat e posaçme jepen për të trajtuar ngjarje të veçanta ekonomike, si:
  - Në përgjigjet të pandemisë, janë hartuar konceptdokumente dhe materiale pune



# Roli i FMN-së në reformat e kontabilitetit: Këshilla të posaçme, punë kërkimore dhe analiza (2)

Baza e të dhënave e Pasqyrave të Bilancit të Sektorit Publik (PSBS) është një shembull i mirë i punës kërkimore dhe analizave të kryera që mbështet gjithashtu tërthorazi reformat e bazës kontabël.

- Projekti bëri një çmuarje të serive kohore të PSBS-së për 38 vende nga informacionet që gjenden publikisht




Source: IMF Public Sector Balance Sheet Database.
*Based on a single year of data, in most cases compiled as part of the Fiscal Transparency Evaluation: Albania, 2013; Armenia, 2016; Austria, 2015; Brazil, 2014; Colombia, 2016;The Gambia, 2016; Guatemala, 2014; Kenya, 2013; Lithuania, 2016; Malta, 2016; Mexico, 2016; Peru, 2013; Portugal, 2012; Russia, 2012; Senegal, 2016; Tanzania, 2014; Tunisia, 2013; Turkey, 2013; Uganda, 2015; Uzbekistan, 2016.

# Roli i FMN-së në reformat e kontabilitetit: Këshilla të posaçme, punë kërkimore dhe analizë (3)

Vlera e analizës së bazës së të dhënave PSBS

- Ilustron mundësinë e përpilimit të këtyre të dhënave për vendet e çdo niveli të ardhurash
- Fiscal Monitor ilustron dobinë e të dhënave
- Qartësisht ndihmon në identifikimin e boshllëqeve në të dhënat burimore bazë
- Jep një ide mbi shkallën e pasqyrave të bilancit të sektorit publik
- Rezultatet theksojnë rëndësinë jo vetëm për të parë informacionet mbi rezultatet e qeverive por edhe pozicionin e tyre financiar gjatë kalimit të kohës për të konstatuar qëndrueshmërinë buxhetore
- Evokon një interes për qëndrimin e PSBS-së

# Sfidat

Mbetet shumë sfida:

- Vijon të menduarit e qëmotshëm për analizën buxhetore dhe vendimmarrjen:
  - Prioritetet fokusohen në periudhën afatshkurtër
  - Mbizotëron të menduarit tradicional për raportimin buxhetor
  - Shumë kontabilistë të përgjithshëm vijojnë të fokusohen vetëm te nevojat e raportimit për të qenë në përputhje me standardet e kontabilitetit – pa marrë parasysh nevojat e tjera për raportim
- Miratimi i standardeve të reja të kontabilitetit shpesh nuk shoqërohet me vënie në zbatim
- Burime të kufizuara për vënien në zbatim
  - Reformat kontabël janë të kushtueshme
  - Kufizime në TI dhe personel
  - Mungesa e dijeve – në veçanti të kufizuara janë dijet për raportimin e harmonizuar

# Faleminderit për vëmendjen

SdeClerck@imf.org